

## **PROCESVERBAL**

**Nga vazhdimi i parë i seancës së 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuele  
të mbajtur me datë 29.8.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Shqipe Tahiri, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski e hapi vazhdimin e parë të seancës së 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski sqaroi se në seancë do të shqyrtohet vetëm një pikë dhe ajo është Propozim-procesverbali nga seanca e 26-të, e cila është shtyrë për arsye teknike.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.8.2023, me tekstin e propozuar.

**Nr. 02-3170/5**

**06.09.2023  
Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**